

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“WEST LINE TOURS”**

Në bazë të ligjit nr.9901.dt.14/04/2008. “ Për Shoqëritë Tregëtare “

Sot më datë 01/12/2022 në Lagjen “Kongresi I Elbasanit” te qytetit Elbasanit mbledhet personi madhor i aftë për të kryer veprime juridike:

1. HENRI DUKA

I cili me vullnetin e tij te lire vendosi të krijojë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar konform me ligjet shqiptare , bazuar në dispozitat e mëposhtme referuar ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 “Për shoqëritë tregëtare”

**Neni 1
EMËRTIMI**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të quhet “WEST LINE TOURS” sh.p.k.

**Neni 2
OBJEKTI I SHOQERISE**

Shoqëria “WEST LINE TOURS” sh.p.k. do të ketë si objekt të aktivitetit të saj tregëtar si më poshtë :

“Veprimtari në fushën e Agjensisë turistike në bashkëpunim me subjektet të tjera, e cila organizon vizita apo guida turistike, mësimore apo historike dhe paketa të ndryshme për turistë të huaj apo vendas, duke përfshirë transportin detar, tokësor apo ajror, kombëtar apo ndërkombëtar me mjete të veta ose të tretëve, akomodim në hotele, motele apo bujtina, dhe duke përfshirë dhe ushqimin sipas kërkesave të klientëve.

Shoqëria mund të marrë pjesë në tendera publikë, shtetëror dhe europian, merr financime, lehtësime dhe përfitime si dhe të publikojë artikuj turistikë dhe shërbime në lidhje me to. Organizimi , operimi dhe shitja e shërbimeve në sektorin e turizmit detar ose tokësor.

Shitje biletash avioni, trageti, treni dhe cdo lloji mjete tjeter per te gjitha destinacionet neper bote qe menaxhohen prej shoqerive perkatese qe ofrojne keto sherbime.

Hapjen e Agjensive turistike brenda dhe jashte vendit, sherbime te ndryshme me karakter social.”

**Neni 3
VENDNDODHJA E SHOQËRISË**

Selia dhe ushtrimi I aktivitetit të shoqërisë do të jetë:

“Lagjja “Kongresi i Elbasanit”, rruga “11 Nentori”, pallati Nr.34, Nr. Pasurie 3/45 dhe Zone Kadestrale 8521, qyteti I ELBASANIT.

Shoqëria mund të hapë filiale, përfaqësi, axhensi të tjera në çdo qytet Brënda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Regjimi juridik

Shoqëria është SHOQËRI ME PERGJEGJËSI TE KUFIZUAR. Aktiviteti i saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit të Shoqërisë dhe Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Me Vendim të Asamblesë së Ortakëve/ Ortakut të vetëm të Shoqërisë, Ortaku mund të ndryshojnë Regjimin Juridik të Shoqërisë, nëse në të ardhmen krijohen premisa të favorshme për funksionimin e saj, sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast Ortaku duhet të pershtasi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë dhe të bëjnë regjistrimet e ndryshimeve në Regjistrin Tregëtar, pranë organit kompetent shqiptar.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me ligjin.

Neni 5

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë me afat të përcaktuar kohor. Ndërprerja e aktivitetit të shoqërisë bëhet me një vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 6

KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në shumën 1,000(një mijë) leke i ndarë në 1 kuotë. Ortaku HENRI DUKA ka 100% të kapitalit me vlerë 1 kuotë = 1,000(një mijë) leke. Kapitali themelor është i përbërë nga kontributet e ortakëve/ortaku I vetëm si në para ose në natyrë. Pjesët e kapitalit janë në çdo moment lehtësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie apo ndërmjet ortakëve për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Neni 7

ADMINISTRIMI

Shoqëria në bazë të vendimit të asamblesë së ortakëve, administrohet nga administrator ligjor I zgjedhur.

Administrator I zgjedhur I kësaj shoqërie është z. HENRI DUKA i cili do të ushtrojë të gjitha funksionet sipas statutit të shoqërisë.

Neni 8
VITI FINANCIAR

Viti financiar fillon në datën 01 Janar dhe mbaron në datën 31 Dhjetor. Përfundon viti I parë I cili fillon në datën e rregjistrimit të shoqërisë në rregjistrin tregëtar dhe përfundon në 31 Dhjetor.

Ky Akt-Themelimi I Shoqërisë “WEST LINE TOURS” është shkruar në 4(katër) kopje të njëjta.

ELBASAN më 01/12/2022 .

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË “WEST LINE TOURS”